



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë/ Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i  
Tehnologiju/ Ministry of Education, Science and Technology

*Datë : 27.11.2018*

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të Ligjit nr. 04/04L për Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe në bazë të planit të veprimit të Programit Kombëtar të Shkencës (2010-2015), vazhduar vlefshmëria e PKSH me Vendim të Ministrit të MASHT, datë : 10.03.2016, ref. nr. 49 / 01B

Shpall:

## KONKURS

Për ndarjen e çmimit vjetor

“Shkencëtar i vitit 2018” dhe

“Shkencëtar i ri i vitit 2018”

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka krijuar një fond për çmime vjetore për rezultate të jashtëzakonshme hulumtuese-shkencore brenda një periudhe njëvjeçare (rezultatet shkencore nga shtatori 2017 deri në tetor 2018). Këto çmime synojnë të promovojnë cilësinë në punën shkencore, të inkurajojnë ngritjen në karrierë dhe shpërblimin e përpjekjeve dhe përkushtimin e hulumtuesve shkencorë të cilët janë në proces të avancimit të diturive të tyre në fushën përkatëse të ekspertizës. Këtë vit do të

ndahen 3 (tre) çmime për titullin "Shkencëtar i vitit" dhe 3 (tre) çmime për "Shkencëtar i ri i vitit".

### Kriteret e aplikimit

Mund të aplikojnë shkencëtarët kosovarë të çdo disipline shkencore, të cilët kanë dëshmuar rezultate të larta të punës kërkimore-shkencore. Kandidatët duhet të jenë shtetas të Kosovës dhe duhet të dorëzojnë së paku 3 (tre) rekomandime nga shkencëtarë të tjerë apo institucione kërkimore shkencore, sipas Udhëzuesit për ndarjen e shpërblimit. Kandidati duhet të sjellë një CV dhe një listë lehtë të verifikueshme të botimeve apo të rezultateve shkencore brenda periudhës së përcaktuar.

### Financimi që është vënë në dispozicion

Çmimi "Shkencëtar i vitit", përfshin një shpërblim prej 2000 eurosh për të mbështetur vazhdimin e punës së tyre hulumtuese dhe për të inkurajuar fituesit e çmimit për angazhimin në nisma të reja hulumtuese. Një shkencëtar mund ta fitojë çmimin vetëm njëherë në karrierën e tij shkencore. Për një vit nuk mund të ndahet më shumë se një çmim për një fushë të caktuar shkencore.

Çmimi "Shkencëtar i ri i vitit", përfshin një shpërblim prej 1500 euro dhe do të jepet në baza vjetore për 3 (tre) shkencëtarët që janë në filllet e para të karrierës kërkimore dhe që kanë dëshmuar rezultate dhe potenciale të larta shkencore dhe hulumtuese.

Konkursi mbetet i hapur 10 ditë nga dita e shpalljes publike në gazeta, në uebfaqen e MASHT dhe mediat elektronike.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në arkivin e MASHT.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data: 10.12.2018 (e hënë).

Aplikacioni një udhëzues me shpjegime dhe kërkesa më të hollësishme për aplikim është i disponueshëm në vegëzën e uebfaqes <http://masht.rks-gov.net/konkurs>.

Aplikimi duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur ku të jetë shkruar: Aplikimi për çmimin "Shkencëtar i vitit" apo "Shkencëtar i ri i vitit" në adresën : Rr. "Agim Ramadani" p. n, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Përpos kësaj, një version elektronik i aplikimit duhet të jetë dorëzuar brenda afatit (27 nëntor deri 10 dhjetor 2018, ora 16:00) në adresën: [sebahate.jupolli@rks-gov.net](mailto:sebahate.jupolli@rks-gov.net) në gjuhën shqipe, angleze apo serbe.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.